

MARSELA HARIZAJ

**ROLI DHE EFIKASITETI I TË PYETURIT SI NXITËS
I NDËRVEPRIMIT DHE AFTËSIMIT KOMUNIKATIV
TË NXËNËSVE TË GJUHËS SË HUAJ**

Pyetjet, llojet dhe roli i tyre në ndërveprimin dhe aftësimin komunikativ të nxënësve

Në mësimdhënie të pyeturit është një fenomen i vazhdueshëm në çdo formë. Gjatë gjithë jetës sonë ne pyesim dhe marrim përgjigje. Nëse ky veprim nuk kryhet atëherë ne nuk marrim informacion. Në çfarëdo lënde dhe në çfarëdo forme të pyeturit është pjesë e pandarë e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjithashtu ai luan rol kyç edhe në përcaktimin e mbarëvajtës së nxënësve. Por është tepër e rëndësishme të dimë se çfarë lloj pyetjesh duhet të bëjmë në klasë duke marrë parasysh disa elemente të tilla si: nxënësi, çfarë duhet të testohet, çfarë përgjigje presim, si do të ndihen nxënësit nëse i pyesim, nëse pyetje përgjigjet do të krijojnë kusht për ndërveprim.

Në orët e gjuhëve të huaja dhe konkretisht në ato angleze nxënësit pyeten vazhdimisht, por jo gjithmonë kanë kurajo të kthejnë përgjigje, kjo për arsye të ndryshme. Atëherë duhet të veprohet në mënyrë të atillë që nxënësit të mos shkurajohen dhe të marrin pjesë aktive në mësim. Së pari duhet parë lloji i pyetjeve që shtrohen. Pyetjet janë disa llojesh: formuese, retorike, të shkurtra, të gjata, formuese, përmbledhëse, formale dhe jo formale. Një mësues i mirë pikësëpari duhet të përcaktojë llojin e pyetjes duke i parë nga këndvështrimi i mësipërm. Nëse hyjmë në brendësi për llojin e aftësisë që do testohet si lexim, dëgjim, të folur apo të shkruar, atëherë është e rëndësishme që edhe këto të ndahen në kategori.

Nëse kemi një pjesë leximi pyetjet mund të jenë të strukturuar, të përgjithshme, pyetje nxitëse të mendimit kritik. Në gjuhën e huaj ndërveprimi ndodh midis dy a më shumë pjesëmarrësve nëpërmjet veprimtarive komunikative. Por ndërveprimi ndodh edhe me anë të pyetjeve. Për këtë arsye nëse pyetjet janë të formuluar mirë dhe jo shumë të gjata atëherë nxënësit apo studentët nxitën të flasim dhe të jenë pjesëmarrës në mësim i cili është dhe qëllimi i mësimdhënies.

Çfarë ndodh në klasat tona. Ky studim ka përfshirë studentë të niveleve të ndryshme gjuhësore dhe është parë në këndvështrimin e efikasitetit i të pyeturit për tema të ndryshme në të njëjtin nivel gjuhësor. Nga vëzhgimet studentët janë më të prirur të ndërveprojnë dhe të marrin pjesë aktive në mësim kur pyetjet nuk janë të gjata, kur janë të strukturuar mirë, kur janë të qarta dhe kërkojnë përgjigje të cilat janë koncize. Kur pyetjet janë shumë të gjata dëshira për t'ju përgjigjur është e vogël.

Po kështu në detyra kursi dhe projekte në të cilat janë përcaktuar pyetjet për të cilat duhet të punohet. Përdorimi i pyetjeve ka të bëjë edhe me sasinë e kohës në dispozicion si për orët me gojë ashtu edhe për provimet e pjesshme formuese apo përmbledhëse. Nëse në një fletë provimi ka më tepër ushtrime të cilat përfshijnë një numër të madh pyetjesh të llojeve të ndryshme është 10 pyetje me nga 4 pika për çdo pyetje të cilat kërkojnë shtjellim, atëhere nuk ka rendiment veçanërisht në tematika të tilla si letërsia apo kultura. Nëse ky numër reduktohet në 5 për një hark kohor prej 1 ore apo 1 e gjysmë, atëhere edhe studentët nuk stepen kur shohin këtë fletë provimi por menjëherë fillojnë punën.

Rezultatet tregojnë se ka një tendencë më të madhe për ndërveprim nëse pyetjet janë rreth diskutimeve të ndryshme, tematikave të larmishme, ndërveprim nëpërmjet grupeve të vogla. Gjatë diskutimeve kemi pyetje përgjigje dhe këto përfshijnë në një mënyrë apo në një tjetër si studentët pasiv ashtu edhe ata aktiv. Si tipar i komunikimit të pyeturit është vendimtar edhe në menaxhimin e klasës. Pyetjet në mënyrë të pashmangshme gjenerojnë komunikim. Tipologjitë e pyetjeve janë të ndryshme.

Pyetjet strukturore përdoren për të nxjerrë në pah njohuritë paraprake të nxënësve dhe për të kontrolluar të kuptuarit. Zakonisht ashtu si në jetën e përditshme përdoren fjalët pyetëse dhe këto kërkojnë përgjigje të shkurtra. Në përgjithësi përdoren me nivele elementare apo edhe para mesatare dhe mesatare. Këto janë efikase dhe mund të përdoren në veprimtari komunikative të ndryshme të cilat i vënë pjesëmarrësit në diskutime pyetje përgjigje.

Zakonisht ato pyetje referuese të cilat janë të hapura janë shumë efikase për tu përdorur në gjuhën e huaj sepse duke qenë se janë të gjera, mund të ketë përgjigje të shumfishta dhe kërkojnë një nivel më të lartë të të menduarit nga nxënësit.

Pyetjet fokusohen ashtu siç thamë më lart në koncepte të ndryshme dhe varen edhe nga koha që kemi në dispozicion. Të pyeturit i bën nxënësit të ndërjegjshëm se gjuha mësohet nëse ndërveprohet me të në mënyrë të vazhdueshme. Pyetjet duhet të jenë efektive dhe kjo varet nga formulimi dhe nga vlera. Pyetjet nuk duhet të kërkojnë një përgjigje mekanike, por një përgjigje logjike dhe mundësisht të rrisë kreativitetin.

Përfundime

Të pyeturit përfshin interlokutorët në mënyra të ndryshme duke sjellë ndërveprim dhe forcim të aftësive komunikuese të nxënësve. Për këtë arsye me rëndësi të veçantë është lloji i pyetjeve, mënyra (me gojë ose me shkrim), qëllimi (p.sh. dhënie mendimi, plotësim informacioni etj.) nga e cila varet përgjigja dhe konceptimi e trajtimi nga ana e nxënësit. Të pyeturit shtrihet më gjerë sesa thjesht mbarëvajtja e nxënësit. Lloji dhe shtrirja e pyetjeve në fushat e jetës i bën nxënësit të shprehën lirshëm. Nxënësit ndikohen nga llojet e pyetjeve dhe nxit dëshirën e nxënësve për të marrë pjesë në procesin mësimor në se ato janë të strukturuar mirë, kërkojnë dhënie mendimi, janë krijuese dhe nxitëse. Pra roli dhe efikasiteti i tyre nxit komunikimin dhe përvetësimin e gjuhës së huaj.

Roli dhe efikasiteti i të pyeturit si nxitës i ndërveprimit dhe aftësimit...

BIBLIOGRAFI

- B. Musai, *Koncepti për mësimdhënien me në qendër nxënësin*, Tiranë, 2003.
- C. B. Cazden, *Classroom Discourse*. Portsmouth, NH: Heinemann, 1988.
- D. Allwright, and K. M. Bailey. *Focus on the language classroom: an introduction to classroom research for language teachers*. Cambridge: Cambridge University Press, 1990.
- Didaktika e Gjuhëve të Huaja 1*, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë, 2008.
- G. Thompson, *Teaching Teachers to Ask Questions*. *ELT Journal* 51/2, April 1997.
- Kurrikula Kombëtare e Gjuhëve moderne për Arsimin Parauniversitar*. Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Grup Autorësh, 2000.
- L. Bartlett, *Teacher development through reflective teaching*, 1990. In J. C. Richards and D. Nunan (eds.) *Second Language Teacher Education*. New York: Cambridge University Press.
- P. Ur, *A Course in Language Teaching*. CUP, 1996.
- R. Ellis, *Understanding second language acquisition*. Oxford: Oxford University Press, 1985.

